



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002852/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Sugjerojmë marrjen e masave për vlerësimin e kushteve social-ekonomike, ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes në vazhdimësi për familjen e të moshurës Z.R.*

Drejtuar: Z. Armando SUBASHI
Kryetar i Bashkisë

FIER

I nderuar Z. SUBASHI,

Në portalin [Porta vendore.al](http://Porta.vendore.al), më datë 01.09.2020, është transmetuar kronika me titull: "*Neglizhenca institucionale lë në harresë nënën me tre fëmijë të sëmurë*".

E moshuara Z.R është një nënë e ve, e cila ka tre fëmijë në moshë të rritur, të sëmurë me epilepsi. Dy prej tyre përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, ndërsa i treti, i cili është në gjendje edhe më të rëndë, pasi nuk mund të lëvizë nga krevati dhe rri gjithmonë brenda, nuk e përfiton.

Në kushte ekstreme varfërie, e moshuara apelon për ndihmë, duke kërkuar dhe një pagesë për kujdestare, ndërsa institucionet justifikohen me faktin se djali i tretë nuk përfiton KEMP, pasi ai nuk paraqitet në komision.

E vetme dhe pa asnjë mbështetje, i është dashur të sorollatet sa në njërën zyrë në tjetrën për t'i lidhur Kemp-in fëmijëve të saj, të cilët kanë probleme shëndetësore.

Pas shumë përpjekjesh të saj, dy nga djemtë, përkatësisht të moshës 34 dhe 35 vjeç marrin pagesën e aftësisë së kufizuar, ndërsa djali i vogël, 33 vjeç, që nuk lëviz, e ka zënë krevatin prej vitesh, nuk e merr.

E rritur jetime, ajo rrëfen se e gjithë jeta e saj ka qenë mes vuajtjesh, sakrificash dhe pengjet e një jete të pajetuar siç ajo do të kishte dashur. Edhe pse 70-vjeçarja u shërben tre djemve të sëmurë, ajo nuk e merr shpërblimin e kujdestarisë.

Ajo shprehet se, mes dëshpërimit se kur tre djemtë e saj pësojnë kriza, një nipi i burrit me shtëpi aty pranë, i vjen në ndihmë. Komshinjtë e bashkëfshatarët e familjes pohojnë se, fshati ia di hallet e nevojën. Dhe ata sa kanë pasur mundësi i janë gjetur pranë me ndihma, orendi e ushqime.

Sipas kësaj kronike, prononcimet nga Bashkia Fier, kanë konfirmuar faktin *se familja e saj është trajtuar me ndihma ushqimore gjatë kohës së pandemisë, jo një herë por disa herë, pavarësisht se kjo mohohet nga vetë ajo dhe fqinjët e saj.*

Por, përpos kësaj, e moshuara Z.R kërkon ndihmë nga shteti, pasi gjendja e saj ekonomike është e keqe dhe jeton prej kohësh në mjerim të plotë dhe me probleme të rënda shëndetësore për të tre djemtë e saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, nisur nga kjo kronikë e transmetuar, ka nisur për shqyrtim me iniciativën e tij këtë rast tejet specifik.

Sa më sipër, në kushtet që kjo familje, bën pjesë në target grupin më të rrezikuar nga Covid-19, për shkak të moshës së saj dhe problemeve të shëndetësore që paraqet kjo familje, ju parashtrojmë shqetësimin e mësipërm, duke sugjeruar *marrjen e masave për vlerësimin e kushteve social-ekonomike, ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes në vazhdimësi për familjen e të moshuarës Z.R.*

Lutemi dërgimin e një përgjigjeje lidhur me trajtimin e rastit dhe sugjerimit, brenda një afati 10 ditor, nga marrja dijëni e kësaj shkrese.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit midis institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA